



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:139716

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05512331

C.nr.2263/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Th. nga fshati Komuna e Rahovecit, me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson Studio Ligjore & Financiare "Klinaku" me avokatët nga Prishtina, kundër të paditurës gjyqtar Shyqri Hoxha C.nr. 2767-22 Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,059.29 (njëmijë e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzetë e nëntë cent), jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 27 mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Th. me vendbanim në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të: *"Detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar të i paguajë (kompensojë) 1 (një) pagë mujore neto, në shumën prej 1,059.29 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm"*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.Th. nga fshati Komuna e Rahovecit, me vendbanim në Prizren, përmes të autorizuarit të tij Studio Ligjore & Financiare "Klinaku" me avokatët nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, me datën 07 korrik 2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,059.29 (njëmijë e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzetë e nëntë cent).

Me parashtrësën e datës 23.10.2023 i autorizuari i paditësit e ka plotësuar padinë me prova të reja sipas aktvendimit të kësaj gjykate C.nr.2263/22 të datës 02 tetor 2023.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës për më tepër se 11 vite në SHSKUK në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal në Prizren, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e nënshkruar më 12.06.2018 në mes të palëve për Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e 1 (një) page neto, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës, lartësia e llogaritjes së 1 (një) page neto për shpërblimin jubilar mbështetet në realizimin e pagës së muajit të fundit të paditësit. Tutje ka theksuar se sipas llogarisë, paga mujore dokumentohet nga shërbimi llogaritar i të paditurës, sipas kësaj paga mujore neto e paditësit është 1,059.29 euro, e cila vërtetohet nga lista e pagës, ku sipas përvojës së punës i takon shuma e përgjithshme prej 1,059.29 euro. Në fund ka theksuar pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave (obligative) të Kontratës Kolektive Sektoriale (nenit 17 par.3), Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, paditësi detyrohet që për realizimin e kësaj të drejte të i drejtohet gjykatës kompetente, ku njëherit i propozon gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar të cilat i ka specifikuar me parashtresën e datës 27.11.2023 dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, taksën për padi 41.00 euro, përpilimin e parashtresës shumë prej 104.00 euro, gjithsej në shumë të përgjithshme prej 249.00 euro.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ka theksuar se paditësi A.Th. ka filluar marrëdhënien e punës në SPZ 02.07.2018, ku edhe vazhdon të punojë, ndërsa pjesa tjetër e përvojës së punës nuk është në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren, periudha e punës është 9 vite , 1 muaj dhe 0 ditë (duke filluar nga data 01.11.2005), ku pas refuzimit të kërkesës në emër të 1 page jubilar, i është drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së tij. Ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar nga arsyet se paditësi kërkesën e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në nenin 52 dhe 53, e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Në këtë drejtim, ka shtuar se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar pasi që në kuptim të Nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, kurse me dispozitat nga par.3 të këtij neni është paraparë që shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, kjo do të thotë se shpërblimet jubilar paguhet në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuari mbush 10, 20 dhe 30 vite përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut të ashtuquajtur vit jubilar. Më tej ka theksuar se e paditura e kundërshton në tërësi edhe shumë e kërkuar nga paditësi sepse nuk është llogaritur paga bazë, por në mënyrë paushallë janë cekur vlerat nga sindikata për të gjithë punëtorët e spitalit dhe në rastin konkret, punëtori A.Th. pagën mujore bazë e

ka 659.77 euro e jo 1,059.29 euro, sepse në vlerën 1,059.29 euro janë të llogaritura edhe kujdestarit. Në rastin konkret paditësi marrëdhënien e punës tek i padituri e ka themeluar më 02.07.2018 mund të konstatojmë se paditësi tek i padituri i ka vetëm 3 vite e 11 muaj dhe 0 ditë përvojë pune i ka mbushur më 01.09.2020, andaj sipas kësaj paditësit nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar dhe për këtë arsye ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas arritjes së përgjigjes në padi të të paditurës, si dhe vlerësimit të provave në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse kërkesëpadia e paditësit është e **pa bazuar**.

Gjykata ka vlerësuar provat bashkangjitur padisë dhe përgjigjes në padi si kontratën e marrëdhënies së punës me nr. 1327 dhe titull të postit H-20 , e lidhur mes këtu paditësit A.Th. dhe të paditurës Spitali Rajonal "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren, vërtetimin me nr.amz.1327, të datës 02.06.2022, listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetimin me nr.amz.1327, të datës 18.10.2023, vërtetimin me numër 228 të datës 08.07.2016 të lëshuar nga Qendra e Kryesore e Mjekësisë Familjare në Rahovec, vendimin nr.6140/2012 të datës 23.11.2012 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës në emër të Dr. A.Th. dhe vendimin me nr. ref. 3005 /2007 të datës 08.10.2007 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës në emër të Dr. A.Th.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune, i caktuar në vendin e punës Kardiolog në Spitalin Rajonal "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren dhe i njëjti pranë të paditurës ka gjithsej 5 vite e 3 muaj dhe 13 ditë përvojë pune, fakt ky që u provua edhe përmes vërtetimit të punësimit, e lëshuar nga e paditura me nr.amz.1038, të datës 18.10.2023 ndërsa pjesa tjetër të përvojës në të cilën thirret në padi i njëjti nuk e ka pranë të paditurës dhe atë 2 vite, i ka në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin në emër të shpërblimit për një pagë jubilarë.

Provat e tjera të ofruara nga ana e palës paditëse të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr. 6140/2012 të datës 23.11.2012 dhe vendimi me nr. 3005/2007 të datës 08/10/2007, vërtetojnë faktin se paditësi ka parashtruar kërkesë për lejimin e specializimit në lëminë e nefrologjisë dhe lejimin e ndrrimit të këtij specializimi nga lëmia e nefrologjisë në atë të kardiologji, por askund nuk mund të vërtetohet periudha e punës e paditësit pranë ishtitucioneve

Pala paditëse kërkesën për kompensimin e një page jubilarë për 10 vite të përvojës në punë e ka parashtruar duke ju referuar dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale (KKS). Gjykata duke u bazuar në nenin 2 të KKS (mbi afatin e zbatimit të kontratës) dhe Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, ku në pikën V përcaktohet se Kontrata Kolektive Sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data **11.06.2018 - 10.06.2021**, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që *“punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit”*, erdhi në përfundim se paditësi megjithëse i ka gjithsej 13 vite 11 muaj e 0 ditë të përvojës në punë, të njëjtat nuk i ka tek e paditura (punëdhënësi i fundit) ndaj të cilit ka paraqitur padi dhe kërkon përmbushjen e këtij detyrimi, kusht ky i kërkuar sipas nenit 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale, për fitimin e shpërblimit jubilar. Nga provat e lartcekura del se paditësi pranë të paditurës deri me datën 10.06. 2021 kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka 2 vite, e 11 muaj përvojë pune dhe si e tillë kërkesa e paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në punë është e pa bazuar dhe u refuzua si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale dhe Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023. Ndërsa orovat e tjera të ofruara nga ana e palës paditëse të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr. 6140/2012 të datës 23.11.2012 dhe vendimi me nr. 30005/2007 të datës 08/10/2007, vertetojnë faktin se paditësi ka parashtruar kërkesë për lejimin e specializimit në lëminë e nefrologjisë dhe lejimin e ndrrimit të këtij specializimi nga lëmia e nefrologjisë në atë të kardiologji, por askund nuk mund të vërtetohet periudha e punës e paditësit pranë institucioneve shëndetësore tek punëdhënësit i fundit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 dhe nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Numri i lëndës: 2022:139716
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05512331

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2263/22, me datë 27 mars 2024

B. Profesional.

Gjyqtari

Ali Kosova

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.